

Pasqyrat Financiare dhe mënyra e plotësimit të tyre

Në materialin vijues do të jepet një guidë e përgjithshme në lidhje me rregullat bazë, në lidhje me formatin dhe me ndërtimin e PF të ndërtuara sipas SKK.

Materiali është hartuar në formën e një guide të thjeshtë në lidhje me rregullat bazë të paraqitjes dhe ndërtimit të PF si dhe me përcaktimin e lidhjes së tepricave të llogarive sipas listës së llogarive të miratuar nga KKK me zërat përkatës ku ato do të paraqiten në Bilanc apo në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve. Materiali ka si synim kryesor të tij të ndihmojë hartuesit dhe përdoruesit e tjerë të PF në ndërtimin e tyre sipas SKK. Udhëzimet e dhëna në këtë material për përmbledhjen e tepricave të llogarive në zëra të caktuara të bilancit kontabël, të pasqyrës së të Ardhurave dhe Shpenzimeve nuk janë përfundimtare. Tërhiqet vëmendja e lexuesit këtu që lista e llogarive e publikuar nga KKK është *orientuese*. Përdoruesit, njësitë ekonomike mund të shtojnë apo pakësojnë llogari të caktuara të listës së llogarive, në përputhje me nevojat e tyre. Po ashtu, në rastet e paraqitjes së transaksioneve për të cilat nuk gjendet përshtatshmëri në listën e llogarive të paraqitur nga KKK, duhet të gjendet zgjidhja bazuar në rregullat e trajtimit kontabël dhe të paraqitjes në Pasqyrat Financiare të parashikuara në SKK.

Ky material është përgatitur nga grupi i punës i përbërë nga z. Sotiraq DHAMO, znj. Lindita LATI dhe z. Bendis HUSI, dhe është diskutuar në Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit. Në këtë material janë reflektuar vërejtjet dhe sugjerimet përkatëse dhe në fund është bërë miratimi i tij. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit mirëpret çdo kritikë, vërejtje apo sugjerim.

Rregulla të përgjithshme

Pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Parimi i materialitetit është përkufizuar dhe sqaruar në SKK 1, paragrafët 34 deri në 69.

Pasqyrat financiare ndërtohen duke u bazuar në:

- supozime bazë
 1. Njësia ekonomike;
 2. Parimi i vijimësisë;
 3. parimi i kompensimit;

Për sigurimin e informacionit të PF, që të jetë i vlefshëm për përdoruesit e tij, duhet të zbatohen disa Parime të cilat sigurojnë dhe karakteristikat e informacionit kontabël.

- Kuptueshmëria;
- Rëndësia në vendimarrje;
 - *parimi i materialitetit*
- Besueshmëria;
 - Paraqitja me besnikëri*
 - Përparësia e përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore*
 - Paanshmëria*
 - Maturia*
 - Plotësia*
- Krahasueshmëria;
 - *qëndrueshmëria e metodave*

SIPAS SKK 2 Pasqyrat financiare përbëhen nga:

- Bilanci
- Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve
- Pasqyra e lëvizjes së kapitalit
- Pasqyra e flukseve monetare
- Shënimet shpjeguese

Plotësimi i informacionit identifikues

Në faqen e parë të PF duhet të tregohet informacioni vijues i cili lejon përdoruesin të identifikojë qartë dhe shpejt informacionin që ato japin.

- emri i njësisë ekonomike raportuese dhe të dhëna të tjera identifikuese;
- nëse janë PF individuale apo të konsoliduara;
- datën e bilancit ose periudhën kontabël për PF të tjera;
- monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare (lekë);
- shkallën e rumbullakimit të shumave, nëse zbatohet;

Ndërtimi i Bilancit kontabël

- Bilanci Kontabël përbëhet nga tre pjesë:

- aktivet;
- detyrimet;
- kapitali i pronarëve;

- Klasifikimi i tre elementëve të mësipërm në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit bëhet duke u bazuar:

- në parimin e materialitetit;
- për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sinqertë të situatës financiare;

Në bilancin kontabël paraqitet situata financiare e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse. Për këtë arsye, bilanci kontabël duhet të përmbajë dy kolona për shumat e elementëve të tij.

Po ashtu, bilanci duhet të përmbajë edhe një kolonë që titullohet "shënimi" në të cilën, në kraht të elementit përkatës të bilancit, do të shënohet numri i paragrafit në shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare në të cilin gjendet informacioni shpjegues për këtë element.

Në pasqyrën e bilancit duhet të përfshihen të paktën shumat për zërat e mëposhtëm:

	<u>AKTIVET</u>	shenime	Viti raportues	Viti paraardhës
I	AKTIVET AFATSHKURTRA			
1.	Aktive monetare			
2.	Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim			
	Totali 2			
3.	Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
	Totali 3			
4.	Inventari			
	Totali 4			
5.	Aktivët biologjike afatshkurtra			
6.	Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje			
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra			
	TOTAL I AKTIVEVE AFATSHKURTRA (I)			
II	AKTIVET AFATGJATA			
1.	Investimet financiare afatgjata			
	Totali 1.			
2.	Aktive afatgjata materiale			
	Totali 2			
3	Aktivët Biologjike afatgjata			
4	Aktivët afatgjata jomateriale			
	Totali 4			
5	Kapital aksionar i papaguar			
6.	Aktive të tjera afatgjata			
	TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II)			
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)			
	<u>DETYRIMET DHE KAPITALI</u>			

I	DETYRIMET AFATSHKURTRA			
1	Derivativët			
2	Huamarrjet			
	Totali 2			
3	Huatë dhe parapagimet			
	Totali 3			
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra			
5	Provizionet afatshkurtra			
	TOTALI I DETYR. AFATSHKURTRA (I)			
II	DETYRIME AFATGJATA			
1	Huatë afatgjata			
	Totali 1			
2	Huamarrje të tjera afatgjata			
3	Provizionet afatgjata			
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra			
	TOTALI I DETYR. AFATGJATA (II)			
	TOTALI I DETYRIMEVE			
III	KAPITALI			
1	Aksionet e pakicës (përdoret vetëm në pasqyrat financiare të konsoliduara)			
2	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë mëmë (përdoret vetëm në PF të konsoliduara)			
3	Kapitali aksionar			
4	Primi i aksionit			
5	Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)			
6	Rezerva statutore			
7	Rezerva ligjore			
8	Rezerva të tjera			
9	Fitimet e pashpërndara			
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar			
	TOTALI I KAPITALIT (III)			
	TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT (I,II,III)			

Kjo mund të quhet dhe forma e thjeshtuar e paraqitjes së Bilancit.

Për të dhënë informacion më të detajuar në lidhje me zëra të caktuara të bilancit, kur përdoret formati i mësipërm, njësia ekonomike jep informacione sqaruese në shënimet shpjeguese të PF. Psh në paragrafin 3 të shënimeve shpjeguese jepet ky informacion në lidhje me aktive të tjera financiare afatshkurtëra:

3. Aktivët e tjera financiare afatshkurtëra përbëhen si vijon

Aktive të tjera financiare afatshkurtra	Viti 2008	Vitit 2007
<i>Llogari / Kërkesa të arkëtueshme</i>		
<i>Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme</i>		
<i>Instrumente të tjera borxhi</i>		
<i>Investime të tjera financiare</i>		
Totali		

Por, njësi ekonomike mund të zgjedhë që informacionet për nëzërat e bilancit, t'i paraqesë drejtpërdrejt në pasqyrën e Bilancit dhe jo në shënimet shpjeguese. Sipas SKK2 në këtë rast formati i Bilancit mund të paraqitet si vijon:

	<u>AKTIVET</u>	Shenime	Viti 200X1	Viti 200X0
I	AKTIVET AFATSHKURTRA			
1.	Aktive monetare			
2.	Derivativë dhe aktive të mbajtura për tregtim			
(i)	<i>-Derivativët</i>			
(ii)	<i>-Aktivet e mbajtura për tregtim</i>			
	Totali 2			
3.	Aktive të tjera financiare afatshkurtra			
(i)	<i>Llogari / Kërkesa të arkëtueshme</i>			
(ii)	<i>Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme</i>			
(iii)	<i>Instrumente të tjera borxhi</i>			
(iv)	<i>Investime të tjera financiare</i>			
	Totali 3			
4.	Inventari			
(i)	<i>Lëndët e para</i>			
(ii)	<i>Prodhim në proces</i>			
(iii)	<i>Produkte të gatshme</i>			
(iv)	<i>Mallra për rishitje</i>			
(v)	<i>Parapagesat për furnizime</i>			
	Totali 4			
5.	Aktivët biologjike afatshkurtra			
6.	Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje			
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra			
	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA (I)			
II	AKTIVET AFATGJATA			
1.	Investimet financiare afatgjata			
(i)	<i>Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara (vetëm në PF)</i>			
(ii)	<i>Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje</i>			
(iii)	<i>Aksione dhe letra të tjera me vlerë</i>			
(iv)	<i>Llogari / Kërkesa të arkëtueshme afatgjata</i>			
	Totali 1.			
2.	Aktive afatgjata materiale			
(i)	<i>Toka</i>			
(ii)	<i>Ndërtesa</i>			

(iii)	Makineri dhe pajisje			
(iv)	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)			
	Totali 2			
3	Aktivet Biologjike afatgjata			
4	Aktivet afatgjata jomateriale			
(i)	Emri i mirë			
(ii)	Shpenzimet e zhvillimit			
(iii)	Aktive të tjera afatgjata jomateriale			
	Totali 4			
5	Kapital aksionar i papaguar			
6.	Aktive të tjera afatgjata			
	TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA (II)			
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)			
	DETYRIMET DHE KAPITALI			
I	DETYRIMET AFATSHKURTRA			
1	Derivatvët			
2	Huamarrjet			
(i)	Huatë dhe obligacionet afatshkurtra			
(ii)	Kthimet / ripagesat e huave afatgjata			
(iii)	Bono të konvertueshme			
	Totali 2			
3	Huatë dhe parapagimet			
(i)	Të pagueshme ndaj furnitorëve			
(ii)	Të pagueshme ndaj punonjësve			
(iii)	Detyrimet tatimore			
(iv)	Hua të tjera			
(v)	Parapagimet e arkëtuara			
	Totali 3			
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra			
5	Provizionet afatshkurtra			
	TOTALI I DETYR. AFATSHKURTRA (I)			
II	DETYRIME AFATGJATA			
1	Huatë afatgjata			
(i)	Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare			
(ii)	Bonot e konvertueshme			
	Totali 1			
2	Huamarrje të tjera afatgjata			
3	Provizionet afatgjata			
4	Grantet dhe të ardhurat e shtyra			
	TOTALI I DETYR. AFATGJATA (II)			
	TOTALI I DETYRIMEVE			
III	KAPITALI			
1	Aksionet e pakicës (përdoret vetëm në pasqyrat financiare të konsoliduara)			
2	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë mëmë (përdoret vetëm në PF të konsoliduara)			

3	Kapitali aksionar			
4	Primi i aksionit			
5	Njësiti ose aksionet e thesarit (negative)			
6	Rezerva statutore			
7	Rezerva ligjore			
8	Rezerva të tjera			
9	Fitimet e pashpërndara			
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar			
	TOTALI I KAPITALIT (III)			
	TOTALI I DETYRIMEVE KAPITALIT (I,II,III)			

Njësia ekonomike, duke respektuar kërkesën e materialitetit dhe të paraqitjes së sinqertë dhe të vërtetë të situatës financiare të saj, mund të paraqesë zëra shtesë në këto formate. Kërkesat që duhet të zbatohen në këtë rast jepen në SKK 2. Kështu, nëse nuk plotësohet kriteri i materialitetit, njësia ekonomike mund të grupojë një element në një zë me natyrë të përbërë të bilancit kontabël, pa e paraqitur atë si zë më vete. Po ashtu, për njësiti ekonomike të vogla mund të përdoret një formë edhe më e thjeshtuar e këtij modeli të bilancit kontabël, duke paraqitur vetëm zërat të cilat paraqesin thelbësisht situatën financiare të njësisë ekonomike.

Në vijim do të jepet shpjegime në lidhje me tepricat e llogarive që duhet të përfshihen në secilin zë të bilancit në formatin e plotë si më sipër: Numrat dhe emërtimi i llogarive janë dhënë bazuar në listën e llogarive të botuar nga KKK në tetor 2007.

I Aktivët afatshkurtra

1. Aktivët monetare

Në këtë zë përfshihen aktivët monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide. Nisur nga lista e llogarive, në këtë zë do të përfshihen tepricat debitore të llogarive si vijon:

50. Letra me vlerë afatshkurtra

503. Letra me vlerë të pjesëmarrjes

504. Letra me vlerë të huave

51. Banka dhe institucione të tjera financiare

511. Vlera monetare në tranzit

5111. Vlera monetare në tranzit, në lekë

5114. Vlera monetare në tranzit, në monedha të huaja

512. Vlera monetare në bankë

5121. Vlera monetare, në lekë

5124. Vlera monetare, në monedha të huaja

- 53. Vlera në arkë
 - 531 Vlera monetare në arkë
 - 5311. Vlera monetare, në lekë
 - 5340. Vlera monetare, në monedha të huaja
 - 532. Vlera të tjera në arkë
 - 5321. Pulla tatimore
 - 5322. Bileta
 - 5328. Vlera të tjera

Tepricat debitore të llogarive të mëposhtëme do të paraqiten në zërin e Aktiveve monetare të bilancit, nëse plotësojnë kushtin e përkufizimit si ekuivalentë të mjeteve monetare. Në rast të kundërt, ato do të përfshihen në zërin e Aktiveve Financiare Afatshkurtra “Aktive të tjera financiare” ose në nënzërin e II të bilancit “Aktive financiare afatshkurtra të mbajtura për tregtim”

- 54. Hua dhe letra me vlerë të borxhit deri në tre muaj
 - 541. Hua të dhëna
 - 5411. Hua në lekë
 - 5412. Hua në monedha të huaja
 - 543. Letra me vlerë të blera (të mbajtura deri në maturim)
 - 5431. Letra me vlerë të blera, në lekë
 - 5432. Letra me vlerë të blera, në monedha të huaja

- 59. Zhvlerësimi aktiveve financiare
 - 590. Zhvlerësimi i letrave me vlerë
 - 5903. Aksionet
 - 5905. Obligacionet
 - 599. Zhvlerësime të tjera për aktivet financiare

2 . Derivatë dhe aktive financiare të mbajtura për tregtim

2 (i) Derivatët

Në këtë nënzë të bilancit përfshihen derivatët dhe letrat me vlerë, të mbajtura për tregtim. Të tilla mund të jenë aksionet, bonot, bonot korporative, zotërimet në fonde investimesh etj. Tepricat e llogarive që përfshihen në këtë nënzë do të ishin:

- 55. Derivatët dhe instrumentat financiarë
 - 551. Derivatët
 - 5511. Vlera pozitive (aktivet)
 - 590. Zhvlerësimi i letrave me vlerë
 - 599. Zhvlerësime të tjera për aktivet financiare

2. (ii)Aktivet e mbajtura për tregtim

Në këtë nënzë të bilancit paraqiten aktivet e mbajtura për tregtim. Konkretisht, do të përfshihen tepricat debitore të llogarive të grupeve si vijon:

- 552. Instrumente financiare primare për tregëtim
 - 559. Aktive të tjera financiare për tregëtim
 - 590. Zhvlerësimi i letrave me vlerë
 - 5903. Aksionet
 - 5905. Obligacionet

599. Zhvlerësime të tjera për aktivet financiare

Në këtë zë të bilancit do të paraqiten edhe tepricat debitore të llogarive 541 e 543 nëse ato nuk plotësojnë përkufizimin e ekuivalentëve të mjeteve monetare.

3. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Në këtë zë të bilancit përfshihen të gjitha të drejtat afatshkurtra të njësisë ndaj të tretëve të cilat kanë rrjedhur nga veprimet tregtare ose nga investimet afatshkurtra në letrat me vlerë.

3. (i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme

Në këtë nënzë përfshihen të gjitha të drejtat ndaj klientëve për shitjen e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm. Konkretisht, nëse do t'i referohemi listës së llogarive të publikuar nga KKK, në këtë zë do të përfshihen tepricat debitore të llogarive të mëposhtëme:

- 411. Klientë për mallra, produkte e shërbime
- 413. Premtim pagesa të arkëtueshme (kur bëhen shitje me lëshim premtim pagese)
- 414. Klientë për aktivet afatgjata

49. Zhvlerësim i të drejtave dhe detyrimeve

3. (ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme

Pëfshihen të gjitha të drejtat e njësisë ndaj të tretëve që nuk lindin nga shitja e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me arkëtim të mëvonshëm dhe as nga investimet në letrat me vlerë dhe investime të tjera të mbajtura për tregtim.

Në këtë nënzë do të paraqiten dhe tepricat **debitore** të llogarive të furnitorëve, kërkesat ndaj personelit, individëve, debitorëve të tjerë, kërkesat ndaj pjesëmarrjeve dhe shoqërive të grupit, etj. kur ato klasifikohen si afatshkurtra. Pra, në këtë zë do të përfshihen tepricat debitore, por pa u kufizuar vetëm në to, të llogarive vijuese:

- 416. Të drejta për t'u arkëtuar nga proceset gjyqësore;
- 418. Parapagime të dhëna;
- 467. Debitorë të tjerë, kreditorë të tjerë (teprica debitore);
- 465. Të drejta për t'u arkëtuar nga shitjet e letrave me vlerë;
- 444. Tatimi mbi fitimin (teprica debitore);
- 442. Tatimi mbi të ardhurat personale (teprica debitore);
- 443. Tatime të tjera për punonjësit (teprica debitore);
- 449. Tatimi në burim (teprica debitore);
- 4454. Shteti- TVSH për t'u marrë;
- 447. Të tjera tatime për t'u paguar dhe për t'u kthyer (teprica debitore);
- 448. Tatime të shtyra (teprica debitore);
- 451. Të drejta dhe detyrime ndaj pjesëtarëve të tjerë të grupit (teprica debitore);
- 455. Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve (teprica debitore);
- 456. Të drejta ndaj pronarëve për kapitalin e nënshkruar, (teprica debitore);
- 465. Të drejta për t'u arkëtuar nga shitjet e letrave me vlerë;
- 469. Huadhënie afatshkurtër;
- 401. Furnitorë për mallra, produkte e shërbime (teprica debitore);
- 404. Furnitorë për aktivet afatgjata (teprica debitore);
- 469. Huadhënie afatshkurtër;
- 49. Zhvlerësim i të drejtave dhe detyrimeve (detajuar sipas llog. analitike përkatëse).

3. (iii) Instrumente të tjera borxhi

Në këtë zë të bilancit kontabël do të paraqiten tepricat e llogarive që paraqesin borxhet e tjera që shoqëria u ka dhënë të tretëve. Në listën e llogarive nuk parashikohet një grup i caktuar i llogarive për të paraqitur këto lloje instrumentash borxhi, por mundet që ato të paraqiten në tepricat debitore të llogarive 469 "Huadhënie afatshkurtër"

3. (iv) Investime të tjera financiare

Në këtë zë do të paraqiten tepricat debitore të investimeve financiare në formën e qerave financiare dhe të investimeve të tjera të ngjashme.

460. Qera financiare (kur është afatshkurtër dhe ka tepricë debitore)

Nëse do t'i nënshtrohen rivlerësimit, ato do të paraqiten në bilanc me vlerën e tyre të rivlerësuar.

4. Inventari

Në këtë zë të bilancit jepen informacionet për inventarin gjendje në datën e ndërtimit të bilancit. Paraqitja e gjendjes së këtyre inventarëve bëhet në Bilanc me vlerën neto. Në vartësi të llojit të inventarit ky zë mund të paraqitet i ndarë në disa nënzëra. Në vijim do të jepet një informacion në lidhje me atë se tepricat e cilave llogarive të listës së llogarive do të përfshihen në secilin nënzë të inventarëve.

4. (i) Lëndët e para

Në këtë nënzë do të paraqiten tepricat debitoare të llogarive vijuese:

- 31. Materiale
 - 311. Materiale të para
 - 312. Materiale të tjera
 - 3123. Materiale ndihmëse
 - 3124. Lëndë djegëse
 - 3125. Pjesë ndërrimi
 - 3126. Materiale ambalazhimi
 - 3127. Materiale të tjera
- 32. Inventari i imët dhe ambalazhet

Duke qënë se ato paraqiten në bilanc me vlerën e tyre neto, atëhere do të paraqiten në këtë zë edhe tepricat kreditore të llogarive të zhvlerësimit si vijon:

- 391. Zhvlerësimi i materialeve të para
- 392. Zhvlerësimi i materialeve të tjera

4. (ii) Prodhim në proces

Në këtë nënzë do të paraqiten tepricat debitoare të llogarive vijuese:

- 33. Prodhimi në proces
 - 331. Prodhimi në proces
 - 332. Punime në proces
 - 333. Shërbime në proces

Duke qënë se ato paraqiten në bilanc me vlerën e tyre neto, atëherë do të paraqiten në këtë zë edhe tepricat kreditore të llogarive të zhvlerësimit si vijon:

- 393. Zhvlerësimi i prodhimeve në proces

4. (iii) Produkte të gatshme

Në këtë nënzë do të paraqiten tepricat debitoare të llogarive vijuese:

- 34. Produkte
 - 341. Produkte të ndërmjetëm
 - 342. Produkte të gatshëm
 - 347. Nënprodukte dhe produkte mbeturinë

Duke qënë se ato paraqiten në bilanc me vlerën e tyre neto, atëherë do të paraqiten në këtë zë edhe tepricat kreditore të llogarive të zhvlerësimit si vijon:

- 394. Zhvlerësimi i produkteve të gatshëm

4.(iv) Mallra për rishitje

Në këtë nënzë do të paraqiten tepricat debitore të llogarive vijuese:

35. Mallra

Duke qenë se ato paraqiten në bilanc me vlerën e tyre neto, atëhere do të paraqiten në këtë zë edhe tepricat kreditore të llogarive të zhvlersimit si vijon:

395. Zhvlerësimi i mallrave dhe (produkteve) për shitje

4.(v) Parapagesat për furnizime

Në këtë nënzë të bilancit do të paraqiten tepricat debitore të llogarive vijuese:

371. Materiale të para

372. Materiale të tjera

374. Produkte të gatshëm

375. Mallra (dhe produkte) për shitje

376. Gjë e gjallë

5. Aktivet biologjike afatshkurtra

Në këtë grup përfshihen tepricat e llogarive që paraqesin gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve biologjike afatshkurtra, sipas përkufizimit që është dhënë për to në SKK 13.

36. Aktive biologjike (afatshkurtra)

6. Aktivet afatshkurtra të mbajtura për shitje

Në këtë zë të bilancit përfshihen tepricat e llogarive që evidentojnë gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve materiale afatgjata ose aktivet jomateriale, që ka shumë mundësi të shiten brenda 12 muajve të ardhshëm. Pra, nëse drejtuesi i shoqërisë i klasifikon aktivet si të mbajtura për shitje, atëhere tepricat debitore të atyre llogarive të aktiveve, do të paraqiten në këtë zë të bilancit kontabël.

7. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Në këtë zë të bilancit përfshihen tepricat e llogarive që evidentojnë gjendjen dhe ndryshimet në shumat e parapagimeve, të të drejtave të rritura dhe shpenzimet e shtyra në datën e bilancit.

486. Shpenzime të periudhave të ardhme

481. Shpenzime të llogaritura

483. Interesa aktive të llogaritura

487. Të ardhura të llogaritura

II. Aktivët Afatgjata

1. Investimet financiare afatgjata

Në këtë grup përfshihen Aktivët financiare, që nuk mund të realizohen brenda 12 muajve të ardhshëm. Këtu përfshihen investimet në filiale, në pjesëmarrje, në shoqëritë e lidhura si dhe në shoqëritë e tjera ku shoqëria nuk ka as influencë të ndjeshme dhe as kontroll. Po ashtu, në këtë zë paraqiten dhe kërkesa të tjera afatgjata në formën e huave të ndryshme afatgjata të dhëna, në formën e të drejtave ndaj shoqërive të lidhura, etj. Paraqitja në bilanc e këtyre investimeve bëhet me vlerën neto. Prandaj, në këtë zë do të paraqiten terpicat e llogarive të investimeve si dhe terpicat kreditore të llogarive të zhvlerësimeve të tyre.

26 AA Financiare

- 261. Aksione të shoqërive të kontrolluara,
- 262. Aksione të shoqërive të lidhura,
- 263. Aksione të tjera dhe letra me vlerë,
- 265. Huadhënie afatgjatë,
- 268. Të drejta të tjera afatgjatë.

29. Zhvlerësimi i AA

- 296. Për investimet financiare afatgjata,
- 2961. Aksione të shoqërive të kontrolluara,
- 2962. Aksione të shoqërive të lidhura,
- 2963. Të tjera aksione ose letra me vlerë,
- 2965. Huadhënie afatgjatë
- 2966. Të drejta të tjera afatgjata

Po ashtu, paraqiten dhe terpicat debitore të llogarive të mëposhtëme, kur klasifikohen si aktive afatgjata:

45. Të drejta dhe detyrime ndaj palëve të lidhura

- 451. Të drejta dhe detyrime ndaj pjesëtarëve të tjerë të grupit
- 455. Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve
- 457. Dividentë për t'u paguar

Në këtë grup do të paraqiten edhe terpicat e të drejtave ndaj klientëve, dëftesave të arkëtueshme, dhe të drejta të tjera tregtare të cilat klasifikohen si aktive afatgjata. Duke qenë se këto të drejta paraqiten në bilanc me vlerën e tyre neto, atëherë do të paraqitet në këtë grup edhe terpicat kreditore e llogarisë vijuese:

49. Zhvlerësim i të drejtave dhe detyrimeve

2. Aktive afatgjata materiale

Në këtë grup të Bilancit paraqiten aktivët që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas SKK 5. Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën neto të tyre nga **amortizimi dhe zhvlerësimi** i akumuluar. Përfshirja e terpicave të llogarive në vijim do të jepet sipas secilit prej nënzërave të këtij grupi të bilancit:

2 (i) Toka, paraqiten Toka, troje terrene

Në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:

- 211. Toka,
- 2911. Zhvlerësimi për Tokat,

2 (ii) Ndërtesa, përfshihen Ndërtesa, struktura, rrugë dhe investime në objekte me qera

Në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:

- 212. Ndërtesa,
- 2912. Zhvlerësimi për Ndërtesat,
- 2812. Amortizimi për Ndërtesat,

2 (iii) Makineri dhe pajisje, përfshihen Pajisje prodhimi, Mjete transporti dhe Makineri e Pajisje të tjera

Në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:

- 213. Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune,
- 215. Mjete transporti,
- 2913. Zhvlerësimi për instalimet teknike, makineritë, pajisjet, instrumentet dhe veglat,
- 2813. Amortizimi për instalimet teknike, makineritë, pajisjet, instrumente dhe veglat,
- 2815. Amortizimi për mjetet e transportit,
- 2915. Zhvlerësimi për mjetet e transportit.

2 (iv) Aktive të tjera afatgjata materiale

Në këtë zë paraqiten zakonisht Mobiljet dhe Pajisjet e zyrave si dhe aktive të tjera afatgjata materiale që nuk përfshihen në grupet e tjera. Sipas përmbajtjes së tij në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:

- 218. Të tjera AA materiale
 - 2181. Mobilje dhe pajisje zyre
 - 2182. Pajisje informative
 - 2188. Të tjera.
- 2918. Zhvlerësimi për të tjera AA
- 2818. Për të tjera AA materiale

3 Aktivet Biologjike afatgjata

Në këtë grup të aktivitet paraqiten të gjitha aktivet biologjike afatgjata, që plotësojnë kërkesat e përkufizimit të SKK 13. Sipas përmbajtjes së tij në këtë nënzë do të përfshihen tepricat e llogarive si vijon:

- 24. AA biologjike,
 - 284. Amortizimi i AA biologjike
 - 293. Zhvlerësimi Për AA në proces.

4 Aktivet afatgjata jomateriale

Në këtë grup të aktivitet paraqiten të gjithë elementët që plotësojnë përkufizimin e aktiveve jomateriale afatgjata, sipas përkufizimit të SKK 5. Paraqitja në bilanc bëhet për vlerën **neto të tyre nga amortizimi dhe zhvlerësimi** i akumuluar.

- 20. AA Jomateriale

4 (i) Emri i mirë

Në këtë zë do të paraqitet vlera e Emrit të Mirë, që rezulton nga kombinimet e bizneseve në përputhje me kërkesat e parashikura sipas SKK 9. Pra, në këtë zë do të paraqiten tepricat e llogarive vijuese:

- 201. Emri i mirë
- 2801. Amortizimi për emrin e mirë
- 2901. Zhvlerësimi për emrin e mirë

4 (ii) Shpenzimet e zhvillimit

Në këtë nënzë do të paraqiten të gjitha aktivet afatgjata jomateriale të krijuara brenda njësisë, në përputhje me përkufizimin e shpenzimeve të zhvillimit të dhënë në SKK 5, si dhe kriteret për kapitalizimin e tyre. Ato paraqiten në Bilanc me vlerën e tyre neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi. Në këtë zë do të paraqiten tepricat e llogarive vijuese:

- 203. Shpenzime të zhvillimit
- 2803. Amortizimi për shpenzimet e zhvillimit
- 2903. Zhvlerësimi për shpenzimet e zhvillimit,

(iii) Aktive të tjera afatgjata jomateriale

Në këtë nënzë të aktivitet paraqiten aktivet afatgjata jomateriale, të siguruara jo nga vetë njësia ekonomike por nëpërmjet blerjeve, kontributeve, etj Këtu përfshihen aktivet e marra në koncesion, patenta, të drejtat intelektuale, licencat për programe kompjuterike, etj. Paraqitja e tyre në bilancin kontabël bëhet me vlerën neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi.

Në këtë nënzë paraqiten tepricat e llogarive në vijim:

- 205. Koncesione, të drejta të ngjashme, licenca dhe të ngjashme
- 2805. Zhvlerësimi për koncesionet, patentat, liçensat, dhe të drejta të ngjashme
- 2905. Amortizimi për koncesione, patenta, licenca dhe të drejta të ngjashme
- 208. Të tjera AA jomateriale
- 2808. Zhvlerësimi për të tjera AA jomateriale
- 2908. Amortizimi për të tjera AA jomateriale

5 Kapital aksionar i papaguar

Në këtë zë të aktiveve afatgjata të bilancit, do të paraqitet shuma e kapitalit të nënshkruar nga aksionerët që kërkohet të paguhet për një afat më të gjatë se një vit nga data e bilancit kontabël. Konkretisht në këtë zë do të paraqitet teprica e llogarisë:

- 456. Të drejta ndaj pronarëve për kapitalin e nënshkruar (teprica debitore)

kur afati i shlyerjes së kapitalit pritet të jetë i gjatë sipas kuptimit të SKK.

6. Aktive të tjera afatgjata

Në këtë grup të aktivitetit paraqiten kategori të tjera të aktiveve afatgjata që nuk janë përfshirë në zërat dhe nënzërat e mësipërm, të cilat i zotëron njësia ekonomike dhe që i ka klasifikuar si të mbajtura për shitje ose për aktivitetet e ndërprera. Në shënimet shpjeguese duhet të jepet dhe informacioni në lidhje me këto aktive për natyrën, llojin e tyre, etj.

Detyrimet dhe Kapitali

Kjo pjesë e bilancit përbëhet nga detyrimet dhe kapitali.

Detyrimet ndahen, (sipas faktit nëse do të shlyhen brenda ose pas 12 muajve nga data e bilancit apo brenda ciklit operativ të njësisë), përkatësisht në:

- Detyrime afatshkurtra
- Detyrime afatgjata.

Ky klasifikim i saktë ka rëndësi për të siguruar informacionin në lidhje me aftësinë paguese të njësisë, me jetëgjatësinë e saj, etj. Një paraqitje sipas grupeve kryesore të kësaj pjesë të Bilancit do të jepet në vijim:

I.DETYRIMET AFATSHKURTRA

1. Derivativët

Në këtë post do të paraqiten tepricat kreditore të llogarive që paraqesin elementët financiarë të ndryshueshëm.

55. Derivatët dhe instrumentat financiarë

- 551. Derivatët
- 5512. Vlera negative (detyrimet)

2.Huamarrjet

Paraqiten detyrimet e njësisë për huatë me afat të shkurtër të marra nga bankat, nga të tretët me emetim obligacionesh, detyrimet e kësteve të huave afatgjata, etj. Sipas nënzërave kryesorë të këtij zëri, paraqitja do të ishte si vijon:

2 (i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra

Në këtë zë do të përmbliidhen tepricat kreditore të llogarive si vijon:

519. Llogari bankare të zbuluara (overdrafte bankare)

542. Hua të marra

5421. Hua, në lekë

5422. Hua, në monedha të huaja

544. Letra me vlerë të borxhit, të emetuara

5441. Letra me vlerë të emetuara, në lekë

5442. Letra me vlerë të emetuara, në monedhë të huaj

461. Huamarrje afatshkurtra

4611. Bankat

4612. Të tjerë tituj

2 (ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata

Do të përfshihen shumat e detyrimit për pagimin e këstit ose të interesave të huave afatgjata, të qerave financiare, etj. që do të bëhet branda 12 muajve pas datës së bilancit kontabël. Lista e llogarive e paraqitur nga KKK nuk parashikon llogari të veçanta për këstet e huave afatgjata, por n.q.s do të mbahen në të njëjtin emërtim të llogarisë kryesore të huasë, atëherë për huatë bankare do të mund të paraqitej në llogarinë 4681/1 “Kësti i llogaritur” dhe 4681/2 “Interesi i llogaritur”. Nëse interesi i huave afatgjatë do të ishte llogaritur si i maturuar ai do të paraqitej në llogarinë 484 “Interesa pasive të llogaritura”.

2 (iii) Bono të konvertueshme

Në këtë nënzë të bilancit do të paraqiten huamarrjet e marra me anë të bonove (obligacioneve) afatshkurtra që kanë karakteristikën që janë të konvertueshme me aksione ose me obligacione. Këtu do të përfshihen edhe aksionet preferenciale të cilat kanë karakteristikën që mund të konvertohen në aksione të njësisë ekonomike.

Në listën e llogarive nuk parashikohet ndonjë grup apo llogari e veçantë e bonove të konvertueshme. Nisur nga karakteristikat e bonove, njësia ekonomike mund të mbajë në llogari të veçanta analitike të detyrimeve, të gjitha bonot afatshkurtra të emetuara me karakteristikën e të qenit të konvertueshme.

3. Huatë dhe parapagimet

Në këtë grup do të përfshihen të gjitha llogaritë që paraqesin detyrimet tregtare të njësisë ekonomike ndaj të tretëve për mallrat dhe shërbimet e blera e të papaguara, për paradhëniet e marra, detyrimet ndaj punonjësve të vet, detyrimet ndaj shtetit për tatimet e taksat e ndryshme të papaguara, dhe hua të tjera. Në vijim do të jepet përfshirja e llogarive sipas nënzërave kryesorë të këtij zëri:

3(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve

Paraqet të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme. Bazuar në listën e llogarive të publikuar nga KKK, në të do të përmbliidhen terpicat kreditore të llogarive vijuese:

- 401. Furnitorë për mallra, produkte e shërbime
- 403. Premtim pagesa të pagueshme
- 404. Furnitorë për aktivet afatgjatë

3(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve

Paraqet detyrimet e njësisë ekonomike ndaj punonjësve të vet me të cilët ajo ka një kontratë punësimi me kohë të plotë ose të pjesshme. Konkretisht, do të paraqiten terpicat kreditore të llogarive:

- 42. Detyrime ndaj personelit
 - 421. Paga dhe shpërblime
 - 423. Paradhënie për punonjësit

3(iii) Detyrime tatimore

Në këtë zë do të përfshihen të gjitha detyrimet e njësisë ekonomike për të gjitha llojet e tatimeve dhe taksave të llogaritura e të papaguara ndaj shtetit si psh TVSH, Tatimi mbi fitimin, Akcizat, Tatimi mbi të Ardhurat Personale, Tatim në Burim, Tatimet e tjera, si dhe për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, kur ato parashikohen që të shlyhen brenda 12 muajve nga data e ndërtimit të Pasqyrave Financiare. Në mënyrë analitike, në këtë nënzë do të përmbliidhen terpicat kreditore të llogarive vijuese:

- 43. Detyrime për sigurimet shoqërore
 - 431. Sigurime shoqërore dhe shëndetësore
 - 437. Organizma të tjera shoqërore
 - 438. Detyrime të tjera

- 44. Shteti për tatime dhe taksa
 - 441. Akciza
 - 442. Tatim mbi të ardhurat personale
 - 443. Tatime të tjera për punonjësit
 - 444. Tatim mbi fitimin
 - 445. TVSH
 - 4453. Shteti- TVSh për t'u paguar
 - 447. Të tjera tatime për t'u paguar dhe për t'u kthyer (teprica kreditore)
 - 448. Tatime të shtyra (teprica kreditore)
 - 449. Tatimi në burim

3(iv) Hua të tjera

Në këtë zë do të përfshihen të gjitha detyrimet afatshkurtra të njësisë ekonomike që nuk lindin nga blerja e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme. Në këtë nënzë do të përfshihen gjithashtu edhe detyrimet e njësisë ekonomike ndaj individëve, kreditorëve të tjerë, etj. Bazuar në listën e llogarive të publikuar nga KKK, në këtë zë do të përfshihen tepricat kreditore, që konsiderohen si detyrime afatshkurtra, të llogarive vijuese.

- 451. Të drejta dhe detyrime ndaj pjesëtarëve të tjerë të grupit (teprica kreditore)
- 455. Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve (teprica kreditore)
- 456. Të drejta ndaj pronarëve për kapitalin e nënshkruar (teprica kreditore)
- 457. Dividentë për t'u paguar
- 460. Qera financiare afatshkurtër
- 464. Detyrime për blerjet e letrave me vlerë
- 467. Debitorë të tjerë, kreditorë të tjerë (teprica kreditore)

3(v) Parapagimet e arkëtuara

Në këtë nënzë të detyrimeve afatshkurtra paraqiten detyrimet që i kanë lindur njësisë ekonomike nga mjetet monetare të marra në avancë nga të tretët për kryerjen e shërbimeve apo dhënien e mallrave apo produkteve brenda një afati të shkurtër kohor. Në vijim jepet teprica kreditore e llogarisë që përmbledhet në këtë zë të detyrimeve:

- 409. Parapagime të marra

4. Grantet dhe të ardhurat e shtyra

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra do të paraqiten grantet e marra nga njësi ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur në të ardhura nga njësi ekonomike.

Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht, si dhe të gjitha të ardhurat e papërfituara ekonomikisht për mjetet monetare të marra në avancë dhe që njësia ekonomike do t'i njohë si të ardhura duke i shpërndarë në periudhat e ardhme dora dorës më kryerjen e shërbimeve.

Në këtë zë të detyrimeve afatshkurtër do të paraqiten tepricat kreditore të llogarive vijuese:

- 466. Grante
 - 4661. Afatshkurtra
- 484. Interesa pasive të llogaritura
- 488. Të ardhura të periudhave të ardhme

5. Provizionet afatshkurtra

Paraqet të gjitha detyrimet afatshkurtra të njësisë ekonomike për të cilat njësia nuk ka siguri të plotë në lidhje me datën dhe shumën e shlyerjes së detyrimit, por që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme. Bazuar në listën e llogarive të botuar nga KKK, në këtë post do të përfshihen tepricat debitore të llogarive të provizioneve që janë klasifikuar si afatshkurtër.

- 463. Provizionet
 - 4631. Afatshkurtër

Lista e llogarive parashikon një llogari të vetme sintetike për provizionet e njësisë. Por, njësia ekonomike, bazuar në llojet e ndryshme të provizioneve që mund të njohë sipas SKK 6, mund të çelë llogari për paraqitjen e detyrimit për provizione për secilin lloj të tyre.

II. DETYRIMET AFATGJATA

Në këtë grup të detyrimeve do të paraqiten të gjitha ato detyrime të cilat njësia ekonomike, në përputhje me kriteret e klasifikimit të detyrimeve të specifikuar në SKK, i klasifikon si detyrime afatgjata. Në vijim do të jepen grupet kryesore ku paraqiten në bilanc këto detyrime si dhe tepricat e llogarive që përmbledhen në to.

1. Huatë afatgjata

Paraqet detyrimet e njësisë për huatë e marra nga bankat, me obligacione, qera, provizionet etj. Me afat të gjatë shkyerje të tyre.

Sipas formës së plotë të bilancit kontabël ato mund të paraqiten në disa nënzëra e konkretisht:

1(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare

Në këtë nënzë të bilancit do të paraqiten tepricat kreditore të llogarive vijuese:

- 468. Huamarrjet afatgjatë
 - 4681. Bankat
 - 4682. Obligacionet
 - 46821 Primi i Obligacionit
 - 46822 Zbritja e obligacionit
- 460. Qera financiare

1 (ii) Bonot e konvertueshme

Bono të konvertueshme afatshkurtra ose aksionet e preferuara

Në këtë nënzë të bilancit do të paraqiten huamarrjet e marra me anë të bonove (obligacioneve) afatgjata që kanë karakteristikën që janë të konvertueshme me aksione ose me obligacione. Këtu do të përfshihen edhe aksionet preferenciale të cilat kanë karakteristikën që mund të konvertohen në aksione të njësisë ekonomike.

Në listën e llogarive nuk parashikohet ndonjë grup apo llogari e veçantë e bonove të konvertueshme. Nisur nga karakteristikat e bonove, njësia ekonomike mund të mbajë në llogari të veçanta analitike të detyrimeve, të gjitha bonot afatgjata të emetuara me karakteristikën e të qenit të konvertueshme.

2.Huamarrje të tjera afatgjata

Në këtë zë do të përfshihen të gjitha detyrimet afatgjata të njësisë ekonomike që nuk lindin nga blerja e mallrave, produkteve dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme. Në këtë nënzë do të përfshihen gjithashtu edhe detyrimet e njësisë ekonomike ndaj individëve, kreditorëve të tjerë, etj. Po kështu, këtu do të paraqiten dhe detyrimet ndaj furnitorëve kur klasifikohen si afatgjatë. Bazuar në listën e llogarive të publikuar nga KKK, në këtë zë do të përfshihen tepricat kreditore, që konsiderohen si detyrime afatgjata, të llogarive vijuese.

- 451. Të drejta dhe detyrime ndaj pjesëtarëve të tjerë të grupit (teprica kreditore)
- 455. Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve (teprica kreditore)
- 456. Të drejta ndaj pronarëve për kapitalin e nënshkruar (teprica kreditore)
- 457. Dividentë për t'u paguar
- 464. Detyrime për blerjet e letrave me vlerë
- 467. Debitorë të tjerë, kreditorë të tjerë (teprica kreditore)
- 401. Furnitorë për mallra, produkte e shërbime
- 403. Premtim pagesa të pagueshme
- 404. Furnitorë për aktivet afatgjata
- 409. Parapagime të marra

3. Provizione afatgjata

Në këtë zë të bilancit do të paraqiten të gjitha detyrimet e klasifikuara si provizione të cilat njësia ekonomike do t'i shlyejë pas më shumë se 12 muaj nga data e bilancit kontabël. Edhe për provizionet afatgjata vlen komenti i bërë më parë në këtë material për provizionet afatshkurtra. Bazuar në listën e llogarive të botuar nga KKK, në këtë post do të përfshihen tepricat debitore të llogarive të provizioneve që janë klasifikuar si afatgjatë.

463. Provizionet
4632. Afatgjatë

Llogaritë e Provizioneve afatgjata mund të jenë klasifikuar sipas parashikimeve për llojet e provizioneve të bëra në SKK 6 “Provizionet”

4. Grantet dhe të ardhurat e shtyra

Në këtë grup të detyrimeve afatgjata do të paraqiten grantet e marra nga njësia ekonomike, dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur në të ardhura nga njësia ekonomike, dhe kjo njohje do të bëhet për një periudhë mbas 12 muajsh pas datës së bilancit kontabël. Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht, si dhe të gjitha të ardhurat e papërfituara ekonomikisht për mjetet monetare të marra në avancë dhe që njësia ekonomike do t'i njohë si të ardhura duke i shpërndarë në periudhat e ardhme pas më shumë se 12 muaj, dora dorës me kryerjen e shërbimeve.

Në këtë zë të detyrimeve afatgjata do të paraqiten tepricat kreditore të llogarive vijuese:

466. Grante
4662. Afatshkurtra
484. Interesa pasive të llogaritura
488. Të ardhura të periudhave të ardhme

III KAPITALI

Sipas përcaktimit të bërë në SKK kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësisë ekonomike. Në zbatim të SKK 2 njësia ekonomike duhet të pasqyrojë, bazuar në parimin e materialitetit, elementët përbërës të kapitaleve të veta. Në vijim do të jepet trajtimi i zërave të parashikuara nga modeli i Bilancit Kontabël sipas SKK 2.

1. Aksionet e pakicës

Ky është një zë që përdoret vetëm në rastin e ndërtimit të pasqyrave të konsoliduara sipas SKK. Në këtë zë të kapitaleve të veta do të paraqitet ajo pjesë e aktiveve neto të njësive të kontrolluara në grupin e konsoliduar, që nuk i përkasin shoqërisë mëmë. Normalisht njësia ekonomike nuk ka llogari të veçantë të pasqyrojë këto marrëdhënie. Po ashtu, duhet të mbahet parasysh se lista e llogarive shërben për ndërtimin e PF individuale. Prandaj, ky është një zë që llogaritet dhe evidentohet gjatë procesit të ndërtimit të Pasqyrave Financiare.

2. Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë mëmë

Ky është një zë që përdoret vetëm në rastin e ndërtimit të pasqyrave të konsoliduara sipas SKK. Në këtë zë të kapitaleve të veta do të paraqitet ajo pjesë e aktiveve neto të njësive të kontrolluara në grupin e konsoliduar, që i përkasin shoqërisë mëmë. Edhe këtu vlejnjë komentet e bëra në paragrafin më sipër.

3. Kapitali aksionar

Paraqitet kapitali i kontribuar nga aksionerët ose nga ortakët. Në këtë zë do të përmbliidhen tepricat kreditore të llogarive vijuese:

- 101. Kapitali i paguar
- 102. Kapitali i nënshkruar i papaguar

4. Primi i aksionit

Do të paraqiten arkëtimitet e bëra gjatë emetimit të aksioneve / kapitalit me vlerën e emetimit mbi vlerën nominale të tyre ose nën vlerën nominale. Pra, përfshihen si shtesat ashtu dhe pakësimet e vlerës në emetimin e aksioneve me vlerën e emetimit të ndryshme nga vlera nominale e tyre.

Në këtë zë do të përmbidhen tepricat kreditore të llogarive vijuese:

- 104. Prime të lidhur me kapitalin
- 105. Zbritje të lidhura me kapitalin

5. Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)

Në këtë zë paraqitet vlera e Aksioneve të veta që njësia ekonomike raportuese i ka riblerë. Sipas listës së llogarive të botura nga KKK, do të përfshihet në këtë zë teprica e llogarisë vijuese:

- 103. Aksione të thesarit

6. Rezervra statutore

Do të paraqiten rezervimet kontabël nga fitimi i bërë bazuar në kërkesat e statutit të njësisë ekonomike. Ato mund të jenë të llojeve të ndryshme dhe njësia ekonomike, në varësi të materialitetit dhe të nevojës për informacion në lidhje me rezervimet nga fitimi sipas kërkesave statutore, mund të përdorë nënlllogari të veçanta për të evidentuar më vete ato. Sipas listës së llogarive të publikuar nga KKK në këtë zë do të përfshihet teprica e llogarisë vijuese:

1073 Rezerva statutore

7. Rezerva ligjore

Në këtë zë do të paraqiten të gjitha rezervimet e detyrueshme kontabël që bën nga fitimi njësia ekonomike bazur në kërkesat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" apo të ndonjë ligji tjetër.

Sipas listës së llogarive të publikuar nga KKK në këtë zë do të përfshihet teprica e llogarisë vijuese:

1071 Rezerva ligjore

8. Rezerva të tjera

Në këtë zë të kapitaleve të veta do të paraqiten rezervimet e tjera nga fitimi që nuk janë të detyrueshme nga kërkesat statutore apo nga kërkesat e ligjeve të caktuara. Të tilla mund të jenë rezervat për fond garantimi page, rezervat për investime, etj. Në këtë zë do të përfshihen gjithashtu dhe të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e përealizuara dhe që në përputhje me kërkesat e SKK të veçanta nuk përfshihen në rezultatin e periudhës. Këtu përfshihen p.sh, plusvlerat e përealizuara të rivlerësimit të AAM, dhe jomateriale, rezervat që lindin nga diferencat e kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit të njësive ekonomike të huaja dhe gjatë ndërtimit të Pasqyrave Financaire të konsoliduara. Sipas listës së llogarive të publikuar nga KKK në këtë zë do të përfshihet teprica e llogarive vijuese:

106. Rezerva nga rivlerësimi

1078 ... Rezerva të tjera

Njësia ekonomike mund të përdorë nënlllogari të rezervave nga rivlerësimi dhe rezervave të tjera nga fitimi nëse dëshiron që të gëjë këtë një informacion analitik për secilin lloj të tyre.

9. Fitimet e pashpërndara

Në këtë zë do të paraqiten fitimet ose humbjet që njësia ekonomike ka akumuluar nga periudhat paraardhëse dhe që nuk është përdorur për qëllimet e caktuara si p.sh, për dividendë, për rezerva, etj.

Sipas listës së llogarive të publikuar nga KKK në këtë zë do të përfshihet teprica e llogarisë vijuese:

108. Fitimi/Humbja e pashpërndarë

10. Fitimi (Humbja) e vitit financiar

Në këtë zë do të paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore të njësisë raportuese ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve pasi të jetë zbritur tatimi mbi fitimin.

Sipas listës së llogarive të publikuar nga KKK në këtë zë do të përfshihet teprica e llogarisë vijeuse:

109. Rezultati i ushtrimit

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Në zbatim të SKK 2, njësia raportuese mund të përdorë një nga formatet e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve të dhënë në aneksin 2 të SKK2.

Objektivat e pasqyrave të të ardhurave dhe shpenzimeve

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve paraqet performancën financiare të njësisë ekonomike gjatë periudhës kontabël. Ajo strukturohet në mënyrë që të pasqyrojë elementë të ndryshëm të fitimit neto në mënyrë që të sigurohen informacione për nivele të ndryshme të aktivitetit apo për aktivitete të veçanta.

Në mënyrë që të realizohet me vërtetësi pasqyrimi i performancës financiare të njësisë, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve mund të hartohet mbi bazën e dy kritereve të klasifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat pasqyrohen në dy forma të ndryshme të raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Këto formate janë paraqitur më poshtë:

Formati i parë i pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve pasqyron klasifikimin e shpenzimeve sipas natyrës. Shpenzimet grupohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës së tyre homogjene (për shembull amortizimi, blerjet e materialeve, shpenzimet për pagat dhe sigurimet, shërbime nga të tretët, kostot e transportit, shpenzime qeraje, shpenzime për energjinë elektrike apo teknologjike, shpenzimet e reklamave, etj). Këto shpenzime nuk mundësojnë evidentimin e drejtëpërdrejtë të kostove për realizimin e funksioneve apo aktiviteteve të veçanta, pasi ato nuk rishpërndahen mes funksioneve të ndryshme brenda njësisë për efektet e hartimit të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve sipas këtij formati. Kjo metodë mund të jetë e lehtë për t'u zbatuar pasi nuk janë të nevojshme shpërndarjet e shpenzimeve sipas klasifikimit të funksioneve, por të dhënat merren në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga klasa gjashtë e listës së llogarive të propozuar.

Një paraqitje e kësaj forme jepet në vijim ku paraqiten në mënyrë të veçantë llogaritë me të cilat lidhet çdo element i pasqyrës.

A- PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
(Bazuar në klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyrës)

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Referencat Nr llog,	Viti Ushtrimor	Viti Paraardhës
1.	Shitjet neto	701, 705		
2.	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	702-708X		
3.	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces	71		
4	Materialet e konsumuara	601-608X		
5.	Kosto e punës -pagat e personelit -shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	641- 648 641 644		
6.	Amortizimet dhe zhvlerësimet	68X		
7.	Shpenzime të tjera	61-63		
8.	Totali i shpenzimeve (shuma 4 - 7)			
9.	Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+/-3-8)			
10.	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara	761, 661		
11.	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet	762, 662		
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare			
12.1	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata	763,764, 765, 664, 665		
12.2	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat	767, 667		
12.3	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	769, 669		
12.4	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	768, 668		
13	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)			
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9+/-13)			
15.	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	69		
16.	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)			
17.	Elementët e pasqyrave të konsoliduara			

1. Shitjet neto – teprica e llogarive të **grupit 701-705** në varësi të përcaktimit se cili është produkti i aktivitetit kryesor apo thelbësor të funksionimit të njësisë ekonomike
2. Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit - teprica e llogarive të tjera brenda grupit të llogarive 702-708X duke përjashtuar ato që janë marrë në konsideratë në pikën 1. SKK 2 sqaron se në këtë grup të ardhurash përfshihen të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike, duke përfshirë fitimet nga veprimtaritë që nuk janë paraqitur në rrjeshtat e mëposhtëm të kësaj pasqyre. Në këtë zë përfshihen fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, nga investimet në pasuri të patundshme, gjobat për vonesat, fitimi neto që vjen nga ndryshimi i kursit të këmbimit, ndryshimet në llogaritë “Kërkesat e arkëtueshme” dhe “Detyrime për t’u paguar furnitorëve” (nëse rezulton humbje neto ajo evidentohet në zërin shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit.
3. Ndryshimet në Inventarin e Produkteve të Gatshme dhe Prodhimit në Proçes – teprica e llogarisë 71 pasqyron këto ndryshime, ku pakësimet e pozicioneve njihen si shpenzime dhe rritjet e pozicioneve si pakësim i shpenzimeve
4. Materialet e konsumuara - shumat debitore të llogarive të grupit të shpenzimeve 601-608x- të kontrolluar me shumat debitore të pasqyruara në llogaritë e sistemit të llogaritjes së koston së prodhimit (nëse mbahet një e tillë në njësinë ekonomike)
5. Kosto e punës – evidenca e llogarisë së grupit 64 nëse mbahet ky sistem llogarish apo tërësia e evidencave që lidhen me detyrimet që lindin nga puna e bërë dhe në zbatim të kontratës së punës dhe të ligjeve në fuqi, të cilat përfshihen në koston e punës.
6. Amortizimet dhe zhvlerësimet – të cilat pasqyrojnë vlerat e evidentuara gjatë periudhës në debi të llogarive të shpenzimeve të grupit 68. Pra nga ulja e vlerës së

aktiveve afatgjata materiale dhe atyre të investuara në pasuri të patundshme të vlerësuar me kosto.

7. Shpenzime të tjera – që janë realizuar në funksion të aktivitetit kryesor të evidentuara në grupet 61 - 63. Këto shpenzime mund të jenë më të detajuar në varesi të rëndësisë që mund të kenë si dhe të masës që zënë ndaj totalit të këtij grupi.
8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara - sipas metodës së kapitalit për secilën nga nën njësitë e kontrolluara merren evidencat duke i evidentuar përkatësisht të Ardhurat dhe Shpenzimet në llogaritë 761 dhe 661. Pasqyra eidenton diferencat midis llogarisë së shpenzimeve dhe të ardhurave respektive.
9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet - sipas metodës së kapitalit për secilën nga nën njësitë në të cilat ka pjesëmarrje eidentohen të dhënat duke përdorur respektivisht të Ardhurat dhe Shpenzimet në llogaritë 762 dhe 662 (ku termi të lidhura nënkupton pjesëmarrjet). Pasqyra eidenton diferencat midis llogarisë së shpenzimeve dhe të ardhurave respektive.
10. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata - duke përfshirë fitimin/humbjen nga shitja e investimeve financiare afatgjata; të ardhurat nga interesi dhe dividendi mbi investimet financiare afatgjata; fitimi/humbja nga rivlerësimet për të arritur në vlerën e drejtë. Pasqyra eidenton diferencat midis llogarisë së shpenzimeve dhe të ardhurave respektive.
11. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi - Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit mbi huatë, bonot, marrëveshjet e qirasë financiare dhe hua të tjera me interes. Pasqyra eidenton diferencat midis llogarisë së shpenzimeve dhe të ardhurave respektive.

12. Fitimi/humbja nga ndryshimi i kursit të këmbimit të të gjithë zërave të aktivitetit dhe pasivitetit që janë nën efektet e luhatjes së kursit të kërkesave për t'u arkëtuar dhe detyrimeve për t'u paguar që lidhen me veprimtaritë investuese dhe huamarrëse.
13. Fitimi/humbja nga investime financiare afatshkurtra, duke përfshirë ato nga shitja e investimeve financiare afatshkurtra; të ardhurat nga interesi dhe dividendët mbi investimet financiare afatshkurtra; fitimi/humbja nga rivlerësimet e vlerës së drejtë.
14. Elementët e pasqyrave të konsoliduara këto elementë përfshijnë zëra që përdoren në pasqyrat e konsoliduara të të ardhurave dhe shpenzimeve për njohjen e pjesës së fitimit të grupit që u përket aksionerëve të shoqërisë mëmë. Gjithashtu, ato elementë që përdoren në pasqyrat e konsoliduara të të ardhurave dhe shpenzimeve për njohjen e pjesës së fitimit të grupit që u përket aksionerëve të pakicës.

Formati i dytë i pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve bazohet në parimin e evidentimit dhe të shpërndarjes së shpenzimeve sipas aktiviteteve apo funksioneve kryesore duke pasqyruar në këtë mënyrë koston e realizimit të tyre. Në këtë mënyrë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve evidentohen në mënyrë të veçantë kostot e prodhimit / të blerjes të produktit apo të mallrave të shitura, kostot e aktiviteteve jo-kryesore, kostot e shpërndarjes apo të realizimit të aktivitetit të shitjes, kostot e realizimit të aktivitetit të manaxhimit apo administrative. Pra në parim kjo formë e raportimit bazohet në ekzistencën dhe funksionimin e qendrave të kostos si dhe të qendrave të të ardhurave. Kjo metodë siguron një informacion më të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare në krahasim me klasifikimin e shpenzimeve sipas natyrës homogjene, pasi jep informacion për qendrat kryesore të kostos, por shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve mund të sjellë shpërndarje subjektive të shpenzimeve të përgjithshme dhe në përgjithësi është më i vështirë për t'u përgatitur, pasi kërkon një sistem kontabël apo ekstrakontabël të veçantë për të mundësuar të dhënat e klasifikuara sipas kësaj pasqyre.

B- PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
(Bazuar në klasifikimin e Shpenzimeve sipas Funksioneve)

Nr.	Përshkrimi i Elementëve	Referencat Nr llog,	Viti Ushtrimor	Viti Parardhës
1.	Shitjet neto	701, 705		
2.	Kosto e prodhimit / blerjes së mallrave të shitura			
3.	Fitimi (humbja) bruto (1-2)			
4.	Shpenzimet e shitjes			
5.	Shpenzimet administrative			
6.	Të ardhurat e tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
7.	Shpenzime të tjera të zakonshme			
8.	Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
9.	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet	762, 662		
10.	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara	761, 661		
11.	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare			
11.1	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata	763, 764, 765, 664, 665		
11.2	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	767, 667		
11.3	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi	769, 669		
11.4	Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare	768, 668		
12.	Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (11.1+/-11.2+/-11.3+/-11.4)			
13.	Fitimi (humbja) para tatimit (8+/-12)			
14	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	69		
15.	Fitimi (humbja) neto e viti financiar (13-14)			
16.	Elementët e pasqyrave të konsoliduara			

1. Kosto e prodhimit / blerjes së mallrave të shitura – Kosto e prodhimit të produkteve, kosto e blerjes së mallrave dhe kosto e realizimit të shërbimeve të shitura gjatë periudhës kontabël, si dhe humbjet e prodhimit, bashkë me kostot e ngjashme të prodhimit që nuk janë përfshirë më parë në koston e mallrave të shitura. Ky element i pasqyrës përlllogaritet dhe evidentohet nëpërmjet llogarisë akumuluese kalkuluese “Kosto e mallrave të shitura “ në të cilën regjistrimi fillestar në debi është në kredi të llogarisë ”Produkte të gatshme” duke shprehur koston e Prodhimit të produkteve të shitura. Nëse njësi ekonomike është njësi tregtare atëherë kundërpartia do të ketë kreditimi i llogarisë “Mallra” (pra, përfaqëson shumën debitore të llogarisë akumuluese dhe kalkuluese të koston që përfshin: koston e prodhimit të produkteve të shitura (me kundërparti shumë kreditore të llogarive të grupit 34 “produkte” apo 35 “mallra”, apo 36 “Aktive biologjike”). Në tërësinë e vet ky zë i pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve përfshin koston e blerjes së materialeve direkte (apo lëndë e parë dhe materiale kryesore), koston e punës direkte, shpenzimet e përgjithshme të prodhimit (duke përfshirë kostot indirekte të evidentuara në repartet e prodhimit dhe që i takojnë këtij produkti apo grup-produktesh) etj. (në varësi të specifikave teknike dhe operative të njësisë ekonomike).
2. Shpenzimet e shitjes – përfshijnë të gjitha llojet e shpenzimeve që mundësojnë realizimin e aktivitetit të shitjes. Llogaria grumbulluese kalkuluese e këtyre shpenzimeve i përket një klase të veçantë (p.sh klasa 9, me nën llogari sipas grup produkteve, mallrave apo shërbimeve kryesore). Kundërpartitë e këtyre grup llogarish mund të jenë ose llogaritë e shpenzimeve të klasës gjashtë ose llogaritë e aktivitetit apo të pasivitetit në varësi të sistemit të kalkulimit të koston që aplikon njësi ekonomike. Në fund të periudhës kjo llogari mbyllet duke u mbartur tek llogaria Kosto e Produkteve / Mallrave të shitura (e cila mund të jetë analitike sipas grup produkteve / mallrave kryesore.)
3. Shpenzimet e administratës - përfshijnë të gjitha llojet e shpenzimeve që mundësojnë realizimin e aktivitetit të manaxhimit nga administrata qendrore. Llogaria grumbulluese kalkuluese e këtyre shpenzimeve i përket një klase të veçantë (p.sh klasa 9). Kundërpartitë të kësaj llogarie mund të jenë ose llogaritë e

shpenzimeve të klases gjashte ose llogaritë e aktivitet apo të pasivitet në varësi të sistemit të kalkulimit të kostos që aplikon njësia ekonomike.

4. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit – përfshijnë ato shpenzime që lidhen me realizimin e të ardhurave të tjera të shfrytëzimit.

Organizimi i sistemit kontabël

Organizimi i evidencës për hartimin e kësaj pasqyre mund të realizohet ose duke përdorur sistemin kontabël (pra sistemin e regjistrimit të dyfishtë) ose në mënyrë ekstra kontabël duke riklasifikuar të dhënat e shpenzimeve nga klasa 6 – llogaritë e shpenzimeve.

Metoda Ekstra-Kontabël

Informacioni që duhet për të plotësuar pasqyrën e mësipërme mund të merret nga pasqyrat të cilat hartohen nëse manaxhimi i njësisë ekonomike e gjykon se i duhen të dhënat e kostos sipas produkteve apo shërbimeve. Hartimi i këtyre pasqyrave realizohet me qëllim që të dhënat dhe transaksionet ekonomike të evidentuara në sistemin e llogarive të shpenzimeve sipas natyrës të riklasifikohen dhe të paraqesin kostot e produkteve (apo të proceseve), të shërbimeve apo të aktiviteteve ndihmëse, kostot e aktivitetit të shitjes dhe ato administrative në mënyrë të veçantë. Llogaritja e këtyre kotove mundësohet duke kaluar në dy etapa kyesore:

- **evidentimi** – akumulimi apo grumbullimi në kolonat e veçanta (te cilat janë hapur sipas qendrave të kostos) të shpenzimeve të drejtpërdrejta (apo direkte) dhe në kolona të veçanta sipas aktiviteteve (prodhim, aktivitet ndihmës, shitje dhe administrim qëndron) të cilat janë shpenzime indirekte dhe që duhet të kalojnë në procesin e dytë:
- **shpërndarja** – nënkupton përcaktimin e shumave respektive që do t'i ngarkohen çdo produkti apo grup-produktesh të shpenzimeve duke sjellë mbylljen e kolonave të shpenzimeve të përgjithshme dhe shtimin e shumave në kolonat e shpenzimeve direkte që janë të mbyllura.

Proçesi i shpërndarjes fillon nga departamentet e shërbimeve apo aktiviteteve ndihmëse të cilat janë tërësisht apo pjesërisht në funksion të aktivitetit kryesor. Pastaj vazhdohet me shpenzimet indirekte të departamenteve/ reparteve të prodhimit.

Në njësitë tregtare ky proces është shumë më tepër i thjeshtuar.

Proçesi i shpërndarjes kërkon që të përdoret teknika e koeficientëve të rëndimit të cilat bazohen në veçoritë e njësisive si dhe në parimin unik të përafrimit të kostos të absorbuar sa më afër realitetit.

Metoda Kontabël

Sikurse është përmendur edhe më sipër evidentimi i formimit të kostos së prodhimit mund të realizohet nëpërmjet sistemit të llogarive të shpenzimeve sipas destinacionit apo funksionit duke mundësuar evidentimin e kostos (direkte dhe indirekte) sipas të gjitha hapave të formimit nëpërmjet llogarive përkatëse. Këto llogari mund të jenë: shpenzime prodhimi (analitike sipas produkteve) shpenzime të përgjithshme të prodhimit (analitike sipas departamenteve apo reparteve të prodhimit), shpenzimet e shitjes dhe shpenzimet e drejtimit (pra të administratës qendrore). Shpenzimet e prodhimit dhe shpenzimet e përgjithshme të prodhimit mundësojnë që të kalkulojnë koston e prodhimit të produkteve të prodhimit. Evidentimi kontabël që realizohet për të kalkuluar këtë kosto realizohet duke kaluar në të dy etapat e përmendura më lart si dhe teknikat e shpërndarjes.

Njësia raportuese mund të përdorë një format tjetër të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve nëse kjo është në përshtatje me natyrën e veprimtarisë, kështu mund të përmendim rastin e institucioneve bankare ose shoqërive qiradhënëse, por bazuar në një nga dy kriteret bazë të klasifikimit të shpenzimeve sipas natyrës apo sipas funksionit.

Elementët përbërës të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve mund të jenë të ndryshme në varësi të realizimit të një raportmi më të qartë dhe më të lexueshëm mbi shpenzimet dhe të ardhurat, në përputhje me veçoritë e aktivitetit ekonomik dhe të rezultateve analitike sipas veprimtarive kryesore të njësisë ekonomike.

Në paraqitjen e tyre përfundimtare njësitet ekonomike mund të paraqesin njërën nga klasifikimet e paraqitura më lart por asnjëherë të dyja bashkë për efektet e raportimit.

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

Pasqyra e flukseve monetare tregon hyrjet dhe daljet e mjeteve monetare në një njësi ekonomike raportuese gjatë periudhës kontabël. Këto flukse raportohen në pasqyrën e flukseve monetare të klasifikuara sipas qëllimit si për shembull, fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytëzimit, e investimit ose e financimit. Pasqyra e flukseve monetare ka si qëllim kryesor dhënien e informacioneve për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre të arkëtuara dhe të paguara nga një njësi ekonomike gjatë një periudhe ushtrimore.

Objektivi kryesor i pasqyrës së fluksit monetar është të përshkruajë:

- mjetet monetare të siguruar e të përdorur nga njësia ekonomike raportuese,
- burimet e financimit, dhe
- ndryshimet në pozicionin e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre në njësinë ekonomike

Ky informacion është shumë i rëndësishëm për vlerësimin e mundësisë që ka apo që i krijohet njësisë ekonomike për të prodhuar dhe përdorur mjete monetare.

Në SKK 2 përcaktohet se metodat kryesore të ndërtimit të pasqyrës së flukseve monetare janë (a) Metoda direkte dhe (b) Metoda indirekte. Ndryshimi i dy metodave paraqitet kryesisht në përcaktimin e fluksit monetar nga veprimtaria e shfrytëzimit.

Pra pasqyra e flukseve monetare, pavarësisht nga metoda përbëhet nga tre pjesë:

- fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytëzimit
- fluksi monetar nga veprimtaria investuese
- fluksi monetar nga veprimtaria financuese

Pasqyra e flukseve monetare – metoda direkte

Thelbi i kësaj metode është kthimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në monetare dhe llogaritja e rezultatit neto direkt në rezultat monetar.

Bazuar në SKK 2, shtojca 3, modeli i pasqyrës së flukseve monetare ndërtuar me metodën direkte paraqitet si vijon:

	Pasqyra e fluksit monetar – Metoda direkte	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
	Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
	Mjetet monetare (MM) të arkëtuara nga klientët		
	MM të paguara ndaj furnitorëve dhe punonjësve		
	MM të ardhura nga veprimtaritë		
	Interesi i paguar		
	Tatim mbi fitimin i paguar		
	<i>MM neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit</i>		
	Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		
	Blerja e njësisë së kontrolluar X minus paratë e Arkëtuara		
	Blerja e aktiveve afatgjata materiale		
	Të ardhurat nga shitja e pajisjeve		
	Interesi i arkëtuar		

	Dividendët e arkëtuar		
	<i>MM neto të përdorura në veprimtaritë investuese</i>		
	Fluksi monetar nga aktivitetet financiare		
	Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		
	Të ardhura nga huamarrje afatgjata		
	Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		
	Dividendë të paguar		
	<i>MM neto e përdorur në veprimtaritë financiare</i>		
	Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		
	Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		
	Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		

Pasqyra e flukseve monetare – metoda indirekte

Thelbi i kësaj metode është kthimi i rezultatit neto nga veprimtaria operative, të llogaritur mbi bazën e kontabilitetit rritës (sipas parimit të të drejtave e detyrimeve të konstatuara) në rezultat të llogaritur mbi baza monetare. Pra rezultati neto i marrë nga Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve korigjohet në rritje me shpenzimet e llogaritura dhe që nuk kanë dalje monetare dhe në ulje me të ardhurat e llogaritura që nuk shoqërohen me hyrje të mjeteve monetare.

Bazuar në SKK 2, shtojca 3, modeli i pasqyrës së flukseve monetare ndërtuar me metodën indirekte paraqitet si vijon:

	Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	Periudha raportuese	Periudha paraardhëse
	Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
	Fitimi para tatimit		
	Rregullime për:		
	Amortizimin		
	Humbje nga këmbimet valutore		
	Të ardhura nga investimet		
	Shpenzime për interesa		
	Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti, si dhe kërkesave të arkëtueshme të tjera		
	Rritje/rënie në tepricën inventarit		
	Rritje/rënie në tepricën e detyrimeve, për t'u paguar nga aktiviteti		
	MM të përfituara nga aktivitetet		
	Interesi i paguar		
	Tatim mbi fitimin i paguar		
	<i>MM neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</i>		

	Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		
	Blerja e shoqërisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		
	Blerja e aktiveve afatgjata materiale		
	Të ardhura nga shitja e pajisjeve		
	Interesi i arkëtuar		
	Dividendët e arkëtuar		
	<i>MM neto e përdorur në aktivitetet investuese</i>		
	Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare		
	Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner		
	Të ardhura nga huamarrje afatgjata		
	Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		
	Dividendët e paguar		
	<i>MM neto e përdorur në aktivitetet financiare</i>		
	Rritja/rënia neto e mjeteve monetare		
	Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël		
	Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël		

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Kjo pasqyrë, sipas parashikimeve të bëra në SKK 2, ndërtohet për të siguruar informacion në lidhje me ndryshimet në kapitalin e vet dhe të faktorëve që kanë ndikuar në këto ndryshime. Në këtë pasqyrë të paktën duhet të jepet informacion në lidhje me gjendjen në fillim të periudhës (apo në fund të periudhës raportuese) të kapitalit të vet, e klasifikuar kjo gjendje sipas paraqitjes në Bilancin Kontabël, e shtesave dhe pakësimeve të kësaj gjendje nga kontributet apo tërheqjet e kapitalit nga pronari, nga rezultati i aktivitetit të biznesit, nga rezervimet e fitimit, nga shpërndarja e dividendëve.

Në vijim jepet një model i një pasqyrë të ndryshimeve të kapitalit sipas parashikimit të bërë në SKK 2.

Udhëzimet dhe mënyrat konkrete të ndërtimit të kësaj pasqyre jepen më hollësisht në SKK 3

	Kapitali aksionar që i përket aksionerëve të shoqërisë mëmë								
	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksionet e thesarit	Rezerva statusore dhe ligjore	Rezerva të konvertimit të monedhave të huaja	Fitimi i Pashpërn darë	Totali	Zotërimet e aksionerëve të pakicës	Totali
Pozicioni më 31 dhjetor 2005	X	X	(X)	X	(X)	X			X
Efektet e ndryshimeve në politikat kontabël						(X)			(X)
Pozicioni i rregulluar	X	X	(X)	X	(X)	X			X
Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit					X				X
Totali i të ardhurave apo i shpenzimeve, që nuk janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve					X				X
Fitimi neto i vitit financiar						X			X
Dividendët e paguar						(X)			(X)
Transferime në rezervën e detyrueshme statutoare				X		(X)			-
Emetim i kapitalit aksionar	X	X							X
Pozicioni më 31 dhjetor 2006	X	X	(X)	X	(X)	X			X
Efektet e ndryshimit të kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit					(X)				(X)
Totali i të ardhurave apo shpenzimeve, që nuk janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve					(X)				(X)
Fitimi neto për periudhën kontabël						X			X
Dividendët e paguar						(X)			(X)
Emetim i kapitalit aksionar	X	X							X
Aksione të thesarit të riblera			(X)						(X)
Pozicioni më 31 dhjetor 2007	X	X	(X)	X	(X)	X			X

SHËNIMET SHPJEGUESE

Pjesë përbërëse e raportimit financiar që bën njësi ekonomike me anë të pasqyrave financiare të publikueshme janë edhe shënimet shpjeguese. SKK parashikojnë kërkesat specifike për paraqitjen e informacionit shpjegues në PF për secilin prej elementëve të bilancit kontabël, të të ardhurave dhe shpenzimeve që ato trajtojnë. Kurse SKK 2 parashikon edhe kërkesat kryesore të ndërtimit dhe të paraqitjes së kësaj pjese të pasqyrave financiare të ndërtuara sipas SKK.

Për ndërtimin e pjesës së shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare njësi ekonomike raportuese do të duhet të mbështetet në SKK 2 në lidhje me modelin dhe formën e paraqitjes dhe në të githa SKK e tjera në lidhje me informacionet shpjeguese korrekte që duhet të jepen. Plotësimi i saktë, i qartë dhe në përputhje me kërkesat e SKK2 i shënimeve shpjeguese është një kusht për rritjen e cilësisë dhe të transparencës së informacionit financiar të njësisë ekonomike.

Shënimet shpjeguese duhet të paraqiten sipas një renditje të caktuar, duke siguruar kështu lehtësimin e kuptimit dhe të krahasimit të informacionit që jepet në to. Kështu shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare do të paraqiten në mënyrë sistematike, për shembull sipas renditjes së mëposhtme:

- (a) politikat kontabël
- (b) shënimet që shpjegojnë zërat e pasqyrave kryesore
- (c) shënime të tjera shpjeguese.

Në pjesën e politikave kontabël përgjithësisht jepet informacion për kuadrin kontabël ku është mbështetur njësi ekonomike, psh në SKK dhe në ligjin “Për kontabilitetin dhe PF”, për politikat kontabël kryesore të ndjekura, psh për njohjen e aktiveve, detyrimeve, të drejtave, të ardhurave, shpenzimeve, për vlerësimin e tyre, etj.

Në pjesën e shënimeve shpjeguese të zërave kryesore të pasqyrave financiare, jepet informacioni që gjykohet i nevojshëm dhe i rëndësishëm për të kuptuar drejt këto elementë. Sipas SKK 2 kërkohet që renditja e sqarimeve të zërave të veçantë të pasqyrave financiare në këto shënime të bëhet në përputhje me renditjen e tyre në pasqyrat financiare.

Shoqëria mund të japë edhe informacion tjetër shpjegues shtesë për të dhënë mundësinë e përdoruesve për të kuptuar më mirë nivelin e performancës dhe rreziqeve që shoqërojnë ato në të ardhmen, psh mund të japë informacion për provizionet, për aktivet dhe pasivet e kushtëzuara, për palët e lidhura, etj.